

LIGJ
Nr. 34/2019

**PËR ADMINISTRIMIN E PASURIVE TË SEKUESTRUARA
E TË KONFISKUARA**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është miradministrimi dhe përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara nga organet e drejtësisë dhe pasurive të sekuestruara me urdhër të ministrit përgjegjës për financat, rikthimi në komunitet i pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme dhe kompensimi financiar i viktimave të krimit.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara” (në vijim Agjencia) është institucioni përgjegjës për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

b) “Administrim i pasurisë” janë të gjitha veprimet e procedurat ligjore që kryhen nga Agjencia apo nga administratori i pasurisë, me qëllim ruajtjen, mirëmbajtjen, administrimin, menaxhimin dhe, kur është e mundur, shtimin e vlerës së pasurisë që nga çasti i marrjes dijeni për aktin e sekuestrimit e të konfiskimit dhe deri në atë të tjetërsimit ose të revokimit të masës së sekuestrimit të pasurisë.

c) “Administrator koordinator” është punonjësi buxhetor i Agjencisë, i cili koordinon, udhëzon, mbikëqyr dhe kontrollon zbatimin e procedurave ligjore nga administratori i pasurisë për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, sipas fushës përkatëse që ai mbulon.

ç) “Administrator i pasurisë” është personi fizik a juridik, i specializuar në fushën e administrimit të pasurive, i cili është i autorizuar dhe/ose kontraktuar nga Agjencia për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.

d) “Fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit” është fondi që krijohet sipas nenit 37, të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar.

dh) “Marrja në dorëzim e pasurisë” janë veprimet e procedurat ligjore të kryera nga Agjencia dhe administratori i pasurisë për kalimin faktik të pasurive në administrim të Agjencisë, me anë të inventarizimit të dokumentuar të pasurisë.

e) “Menaxhim me anë të të tretëve” janë veprimet dhe procedurat që kryhen nga Agjencia me anën e të tretëve, duke ua dhënë atyre me qira, pas marrjes në dorëzim të pasurisë deri në çastin e tjetërsimit të saj.

ë) “Pasuritë e regjistruara” janë pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, të regjistruara në regjistra publik, pasuritë e luajtshme dhe shumat monetare, të regjistruara pranë institucioneve financiare ose subjekte të licencuara nga organet përkatëse shtetërore për ruajtjen e tyre, pasuritë dhe kuotat e aksionet e shoqërive tregtare, të regjistruara në regjistrin e shoqërive tregtare.

f) “Personel i jashtëm”, sipas këtij ligji, është administratori i pasurisë së konfiskuar, administratori i pasurisë të bllokuar e të sekuestruar me urdhër administrativ dhe administratori i pasurisë së sekuestruar, i caktuar nga gjykata, si dhe punonjësit e tjerë ndihmës të administratorit.

g) “Përdorim i pasurisë” është ushtrimi i së drejtës për shfrytëzimin e pasurisë.

gj) “Tjetërsim” është kalimi i të drejtave reale të pasurisë nga pronari tek të tretët, nëpërmjet njërës prej formave të parashikuara nga Kodi Civil dhe legjislacioni në fuqi.

h) “Të ardhurat nga administrimi i pasurive” janë të gjitha të hyrat në vlera monetare që përfitohen nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe/apo konfiskuara, apo burime të tjera të ligjshme.

i) “Shpenzimet për administrimin e pasurive” janë të gjitha të dalat në vlera monetare, që përdoren për administrimin e pasurive.

j) “Urdhër administrativ” është urdhri i lëshuar nga ministri përgjegjës për financat, sipas ligjit nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

Neni 3

Objekti

Ky ligj përcakton rregullat, procedurat dhe strukturën administrative për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga organet e drejtësisë apo me urdhra administrativë, sipas përcaktimeve të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 4

Fusha e zbatimit

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për:

a) pasuritë e sekuestruara e të konfiskuara me vendim të gjykatës kompetente, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit;

b) pasuritë e bllokuara e të sekuestruara, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për masat kundër financimit të terrorizmit;

c) pasuritë, për të cilat është vendosur masa e sekuestrimit preventiv, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, dhe ato të konfiskuara me vendim të gjykatës kompetente, sipas dispozitave të Kodit Penal, të cilat janë produkt i veprave penale apo të lidhura me to.

Neni 5

Parimet e përgjithshme

Administrimi i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara realizohet duke respektuar parimet e miradministrimit, efektivitetit, eficiencës, ekonomikitetit, transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe të shmangies, shpërdorimit e keqpërdorimit.

Neni 6

Organizimi dhe funksionimi

1. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara është person juridik publik, buxhetor, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës për financat.

2. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat.

3. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të Agjencisë rregullohen nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen sipas parashikimeve të Kodit të Punës.

4. Kriteret profesionale, si dhe ato për autorizimin dhe/ose kontraktimin e personelit të jashtëm përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.

5. Kufijtë e pagave apo shpërblimit të personelit të jashtëm përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Rregullat e hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara caktohen në rregulloren e saj të brendshme.

Neni 7

Buxheti

1. Buxheti i Agjencisë financohet nga:

- a) buxheti i shtetit, si pjesë përbërëse e buxhetit të ministrisë përgjegjëse për financat;
- b) të ardhurat e krijuara nga administrimi i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara;
- c) të ardhurat e krijuara nga tjetërsimi i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara;
- ç) donacionet dhe/ose dhuratat në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- d) burime të tjera, të ligjshme.

2. Buxheti i shtetit mbulon shpenzimet për mbajtjen dhe funksionimin e Agjencisë, si dhe ato për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, vetëm në rastet kur të ardhurat e siguruara nëpërmjet administrimit të këtyre pasurive nuk janë të mjaftueshme.

3. Të ardhurat nga administrimi i pasurive përdoren nga Agjencia vetëm për të mbuluar shpenzimet e administrimit të pasurive.

4. Të ardhurat e përfthuara nga tjetërsimi i pasurive të konfiskuara shkojnë në:

- a) buxhetin e shtetit;
- b) fondin e posaçëm për parandalimin e kriminalitetit;
- c) llogarinë e Agjencisë.

5. Shpërndarja e të ardhurave të përfthuara nga tjetërsimi i pasurive të konfiskuara, sipas pikës 4, të kësaj dispozite, përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për financat.

Neni 8

Kompetencat dhe përgjegjësitë

Agjencia ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

a) merr në dorëzim pasuritë e sekuestruara e të konfiskuara, sipas përcaktimeve të nenit 3 të këtij ligji;

b) administron, mirëmban dhe ruan pasuritë e sekuestruara e të konfiskuara, nëpërmjet administrimit të drejtpërdrejtë apo të të tretëve. Nëse është e mundur, rrit vlerën e pasurisë në administrim;

c) me vendim të gjykatës, realizon shitjen e pasurive të luajtshme të sekuestruara, të cilat me kalimin e kohës prishen, dalin jashtë përdorimit apo u bie vlera në mënyrë të ndjeshme;

ç) kryen regjistrimin në favor të shtetit, të pasurive të regjistruara të konfiskuara, në regjistrat përkatës;

d) përgatit dokumentacionin e plotë për tjetërsimin apo dhënien në përgjegjësi administrimi, të pasurive të konfiskuara;

dh) bashkëpunon për shitjen e pasurive të konfiskuara me institucionet përgjegjëse për shitjen e pronave publike;

e) mbikëqyr veprimtarinë e përfituesit nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit, të cilit i është dhënë në përdorim, përgjegjësi administrimi apo huapërdorje një pasuri e konfiskuar, nëse përdorimi i pasurisë është apo jo në përputhje me udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat të nxjerrë për këtë qëllim;

ë) bën verifikimin dhe përgatit dokumentacionin për mendim në Komitetin Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar, lidhur me kërkesat për financimin e projekteve nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe edukim ligjor, si dhe ndjek zbatimin e tyre;

f) përgatit dhe administron statistika periodike dhe vjetore për sasinë, llojin dhe vlerën e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara nën administrim.

Neni 9

Kryeadministratori

1. Agjencia drejtohet dhe përfaqësohet nga kryeadministratori, i cili i raporton ministrit përgjegjës për financat. Marrëdhëniet e punës së kryeadministratorit rregullohen nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil.

2. Kryeadministratori ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

a) drejton dhe organizon veprimtarinë e Agjencisë;

b) mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë që kryhet për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara;

c) përfaqëson Agjencinë në marrëdhënie me të tretët, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi;

ç) harton listën e administratorëve të pasurisë së sekuestruar, me persona të punësuar ose jo pranë Agjencisë, të cilën ia paraqet gjykatës, të paktën një herë në vit, brenda tremujorit të parë të vitit. Kriteret dhe rregullat e hollësishme për hartimin e listës së administratorëve miratohen me vendim të ministrit përgjegjës për financat;

d) negocion dhe lidh kontratën me administratorin e pasurisë së sekuestruar, të caktuar nominalisht nga gjykata përkatëse;

dh) autorizon administratorin e pasurisë së sekuestruar nisur nga kërkesa e arsyetuar e tij, të kërkojë ndihmën e një specialisti ose të personave të tjerë, si dhe negocion e lidh kontratën me ndihmësin e administratorit;

e) negocion dhe lidh kontratën me administratorin e pasurisë së bllokuar e të sekuestruar me urdhër administrativ;

ë) negocion dhe lidh kontratën me administratorin e pasurisë së konfiskuar, në rastet kur cakton një person që nuk është punësuar pranë Agjencisë;

f) negocion dhe lidh kontratat e qirasë, huapërdorjes dhe enfiteozës për pasuritë e sekuestruara e të konfiskuara;

g) lidh kontratat si përfaqësues i Agjencisë, në cilësinë e autoritetit kontraktues në procedurat e prokurimit publik;

gj) cakton dhe lidh kontratën me auditues ligjor, në rast kur mungon dokumentacioni përkatës ligjor i pasurisë së sekuestruar, si dhe regjistrat e llogarive të shoqërisë tregtare;

h) cakton masën fikse të pagës dhe të shpërblimit të personelit të jashtëm në përputhje me kufijtë e miratuar;

i) ngre komisionet për:

i. vlerësimin e çmimit të tregut për dhënie me qira të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara;

ii. vlerësimin e çmimit të shitjes së pasurive të konfiskuara;

iii. vlerësimin e çmimit të shitjes për pasuritë e sekuestruara, për të cilat gjykata ka vendosur shitjen e tyre.

Neni 10
Administratori koordinator

Administratori koordinator është nëpunës i administratës së Agjencisë, i cili, sipas sektorit që mbulon, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- a) koordinon, kontrollon dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratorëve të pasurive dhe zbatimin e procedurave ligjore të administrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara;
- b) kontrollon dhe miraton raportet e përgatitura nga administratorët e pasurive, përpara se të kalojnë për miratim te kryeadministratori;
- c) verifikon dhe dërgon për miratim te kryeadministratori kërkesat për shpenzimet për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e pasurive, të propozuara nga administratori i pasurive;
- ç) përgatit statistika, analiza e raporte periodike mujore, si dhe sa herë që i kërkojnë nga kryeadministratori;
- d) në bazë të propozimeve të administratorit të pasurive, i rekomandon kryeadministratorit mënyrën e administrimit të pasurive nëpërmjet administrimit të drejtpërdrejtë apo me anë të të tretëve.

Neni 11
Administratori i pasurisë së sekuestruar

1. Administratori i pasurisë së sekuestruar caktohet nga gjykata kompetente, nga lista e ekspertëve të caktuar nga Agjencia.

2. Administratori i pasurisë ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- a) njofton menjëherë për masën e sekuestrimit për pasuritë e sekuestruara të regjistruara, në organet dhe subjektet ku mbahen këta regjistra;
- b) njofton gjykatën kur konstaton pasuri të tjera, që mund të jenë objekt i masës së sekuestrimit, për ekzistencën e të cilave është vënë në dijeni gjatë administrimit;
- c) merr në administrim pasuritë e sekuestruara që i caktohen për administrim;
- ç) nëse është e mundur, rrit vlerën e pasurisë që ka në administrim;
- d) harton të gjitha shkresat zyrtare dhe mban korrespondencën me institucionet dhe subjektet, me të cilat duhet të bashkëpunohet për marrjen në administrim, menaxhimin dhe tjetërsimin e pasurive të sekuestruara;
- dh) paraqet çdo kërkesë të nevojshme për ekzekutimin e masës së sekuestrimit dhe për administrimin e sendit, pranë prokurorisë, shërbimit përmbarimor apo çdo institucioni tjetër shtetëror;
- e) paraqet:
 - i. raport të hollësishëm, brenda 15 ditëve nga emërimi i tij, për kryeadministratorin dhe autoritetin përkatës që ka vendosur masën e sekuestrimit, për elementet thelbësore të ekzistencës dhe gjendjes së pasurisë së sekuestruar, duke njoftuar njëkohësisht prokurorin e çështjes, kur pasuria është sekuestruar me kërkesë të kësaj të fundit;
 - ii. raport për marrjen në administrim të pasurisë, për të cilin njofton kryeadministratorin, vë në dijeni autoritetin përkatës që ka vendosur masën e sekuestrimit dhe prokurorin e çështjes;
 - iii. raporte periodike për administrimin e pasurive të sekuestruara, sipas afateve të caktuara nga gjykata, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës;
 - iv. kërkesën për informim pranë prokurorisë dhe gjykatës, 30 ditë përpara përfundimit të masës së sekuestrimit, me qëllim marrjen dijeni nga ana e prokurorit të kërkesës për konfiskim apo shtyrje të afatit të sekuestrimit;
 - v. raportin tekniko-financiar, brenda 90 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin e formës së prerë, për konfiskimin e pasurisë;
 - vi. raportin për pasuritë e tjera, që mund të jenë objekt i masës së sekuestrimit, për ekzistencën e të cilave është vënë në dijeni gjatë administrimit, por nuk janë përcaktuar në masën

e sekuestrimit, dhe ia paraqet atë autoritetit përkatës që ka vendosur masën e sekuestrimit dhe kryeadministratorit.

3. Gjykata kompetente mund të shkarkojë kryesisht apo me kërkesë administratorin e pasurisë së sekuestruar nga detyra, në çdo kohë, për paaftësi ose për mospërmbushje të detyrës. Kërkesa në gjykatë paraqitet nga organi procedues, kryesisht ose me propozim të motivuar të Agjencisë.

Neni 12

Administratori i pasurisë së bllokuar e të sekuestruar me urdhër administrativ

1. Administratori i pasurisë së bllokuar e të sekuestruar me urdhër administrativ caktohet nga kryeadministratori.

2. Administratori i pasurisë së konfiskuar ka kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në pikën 2, të nenit 11, të këtij ligji.

Neni 13

Administratori i pasurisë së konfiskuar

1. Administratori i pasurisë së konfiskuar caktohet nga kryeadministratori.

2. Administratori i pasurisë së konfiskuar ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

a) njofton menjëherë, për masën e konfiskimit, për pasuritë e konfiskuara të regjistruara, në zyrat ku mbahen këto regjistra, me qëllim kalimin e pasurive në favor të shtetit;

b) merr në administrim pasuritë e konfiskuara që i caktohen për administrim;

c) nëse është e mundur, rrit vlerën e pasurisë që ka në administrim;

ç) harton të gjitha shkresat zyrtare dhe mban korrespondencën me institucionet dhe subjektet, me të cilat duhet të bashkëpunohet për administrimin, menaxhimin dhe tjetërsimin e pasurive të konfiskuara.

3. Administratori i pasurisë së sekuestruar, i caktuar nga gjykata, në rastet kur pasuria në administrim të tij konfiskohet me vendim gjyqësor, vazhdon ushtrimin e detyrave, në emër dhe për llogari të Agjencisë, për aq kohë sa nuk është zëvendësuar prej saj me administratorin e pasurisë së konfiskuar.

Neni 14

Ndalime për administratorin e pasurisë

1. Administratorit të pasurisë, sipas neneve 11, 12 e 13, të këtij ligji, nuk i lejohet të marrë pjesë në gjykim, të marrë kredi, të nënshkruajë marrëveshje pajtimi, arbitrazhi, premtimi, dorëzanie, hipotekimi ose tjetërsimi, të pasurive të sekuestruara apo të konfiskuara, apo të kryejë veprime të tjera juridike administrimi jo të zakonshëm. Përfshihet nga ky rregull administratori i pasurisë së sekuestruar, në rastet kur autorizohet paraprakisht nga gjykata.

2. Administratori i pasurisë së sekuestruar, i caktuar nga gjykata, nëpërmjet Agjencisë, i paraqet prokurorit kërkesë të argumentuar, ku çmon se duhet të kryhen veprimet juridike, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni. Gjykata, me kërkesë të prokurorit, autorizon veprimet e kërkuara kur e çmon të domosdoshme për ruajtjen e vlerës së pasurisë.

Neni 15

Raportimi

1. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara përgatit:

a) raporte në mënyrë progresive, si gjykatës kompetente, ashtu edhe organit procedues, të gjitha shpenzimet procedurale, që nga çasti i marrjes në dorëzim të pasurisë së administruar, deri në fazën e konfiskimit të saj;

b) raporte për organin që ka vendosur masën e sekuestrimit dhe/apo të konfiskimit për pasurinë e marrë në administrim;

c) raporte për Komitetin Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar për pasuritë e konfiskuara, të paktën një herë në vit, për tremujorin e parë;

ç) raporte të vlerësimit tekniko-financiar për pasuritë e konfiskuara, brenda 90 ditëve nga marrja dijeni e vendimit të formës së prerë.

2. Gjykata thërret kryesisht kryeadministratorin për të marrë informacion për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe për çdo të dhënë tjetër që e konsideron të dobishme për vendimin e konfiskimit. Kryeadministratori mund të delegojë një nëpunës në varësi të tij për t'u paraqitur përpara gjykatës.

Neni 16

Marrja në dorëzim e pasurisë së sekuestruar me vendim të gjykatës kompetente

1. Marrja në dorëzim e pasurisë së sekuestruar bëhet nga administratori i pasurisë së sekuestruar, në prani të administratorit koordinator, të caktuar nga kryeadministratori, me marrjen dijeni të vendimit gjyqësor për vendosjen e masës së sekuestrimit.

2. Pasuria e sekuestruar dorëzohet tek administratori i saj nga Policia Gjyqësore, në përputhje me vendimin gjyqësor, me legjislacionin në fuqi për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, dhe me Kodin e Procedurës Penale. Kjo pikë zbatohet edhe kur personat që preken nga masa e sekuestrimit kanë të drejta reale ose personale për t'i gëzuar pasuritë e sekuestruara.

3. Kur masa e sekuestrimit caktohet ndaj pasurisë së regjistruar, administratori i emëruar njofton menjëherë këtë masë në zyrat pranë të cilave mbahen këta regjistra.

4. Kur sendi mbahet pa titull pronësie ose në bazë të një titulli që daton përpara datës së vendimit të sekuestrimit dhe poseduesi i sendit nuk pranon ta dorëzojë atë vullnetarisht, gjykata urdhëron lirimin e sendit. Urdhri i gjykatës ekzekutohet nga Policia Gjyqësore.

5. Inventari dhe përshkrimi i pasurisë së sekuestruar bëhen nga Policia Gjyqësore dhe dokumentohen në një raport, i cili nënshkruhet nga administratori koordinator, i caktuar nga kryeadministratori, administratori i pasurisë së sekuestruar, i caktuar nga gjykata dhe oficeri i Policisë Gjyqësore, si dhe, sipas rastit, nga të pranishëm të tjerë. Ky raport përmban elementet e parashikuara nga neni 524 i Kodit të Procedurës Civile.

6. Gjatë marrjes në dorëzim të pasurisë së sekuestruar nga administratori, Policia Gjyqësore u dorëzon një kopje të raportit të përmendur në pikën 5, të këtij neni, personave të pranishëm në kohën e inventarit.

7. Në rastin e marrjes në dorëzim të pasurisë dhe të kuotave e aksioneve të shoqërive tregtare të regjistruara në regjistrin e shoqërive tregtare, Policia Gjyqësore dorëzon pasurinë e sekuestruar tek administratori, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës ligjor dhe, nëse ka, edhe me regjistrat e llogarive të shoqërisë tregtare.

8. Administratori i pasurisë, për qëllime të administrimit dhe në mungesë të dokumentacionit të parashikuar në pikën 7, të këtij neni, vë në dispozicion të audituesit ligjor, të caktuar nga kryeadministratori, për të vënë në dispozicion të dhënat e nevojshme për administrimin e pasurisë, duke i kërkuar hartimin e një raporti. Raporti vihet në dispozicion të Agjencisë.

Neni 17

Marrja në dorëzim e pasurisë së sekuestruar me urdhër administrativ

1. Marrja në dorëzim e pasurisë së sekuestruar bëhet nga Agjencia, në përputhje me urdhrin e ministrit përgjegjës për financat dhe me legjislacionin në fuqi për masat kundër financimit të terrorizmit.

2. Administratori i pasurisë së sekuestruar me urdhër administrativ u njofton masën e sekuestrimit të pasurive pronarit të pasurisë dhe personave që preken nga masa.

3. Kur pasuria mbahet pa titull pronësie ose në bazë të një titulli që daton përpara datës së urdhrit administrativ të bllokimit e të sekuestrimit dhe poseduesi i sendit nuk pranon ta dorëzojë atë vullnetarisht, ministri urdhëron lirim të sendit. Urdhri i ministrit për lirim të sendit përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga përmbartimi shtetëror.

4. Inventari dhe përshkrimi i pasurisë së sekuestruar bëhen nga një komision i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për financat, i cili përbëhet nga:

- a) administratori i pasurisë, i caktuar nga kryeadministratori;
- b) një përfaqësues nga Agjencia;
- c) një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

5. Raporti i inventarizimit përmban elementet e parashikuara në nenin 524 të Kodit të Procedurës Civile. Një kopje e raportit u dorëzohet personave të pranishëm në kohën e inventarit.

6. Në rastin e marrjes në dorëzim të pasurisë dhe të kuotave e aksioneve të shoqërive tregtare të regjistruara në regjistrin e shoqërive tregtare, administratori merr në dorëzim pasurinë e sekuestruar, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës ligjor dhe, nëse ka, edhe me regjistrat e llogarive të shoqërisë tregtare.

7. Në rastin e marrjes në dorëzim të pasurisë dhe të kuotave e aksioneve të shoqërive tregtare, të regjistruara në regjistrin e shoqërive tregtare, në mungesë të dokumentacionit përkatës, zbatohen përcaktimet e pikës 8, të nenit 16, të këtij ligji.

Neni 18

Sigurimi i pasurisë

Pas marrjes në administrim të pasurisë, administratori i pasurisë së sekuestruar merr masa për sigurimin e domosdoshëm të pasurisë, duke lidhur kontrata sigurimi për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë. Për sigurimin e këtyre shërbimeve zbatohen procedurat e prokurimit publik.

Neni 19

Administrimi i pasurisë së paluajtshme

1. Administratori i pasurisë së sekuestruar kryen një studim fizibiliteti për pasurinë e marrë në administrim dhe ia paraqet atë kryeadministratorit, i cili merr vendimin përkatës për mënyrën e menaxhimit të pasurisë, nëpërmjet menaxhimit të drejtpërdrejtë nga Agjencia apo të tretë, duke ua dhënë atyre me qira.

2. Administratori i pasurisë së sekuestruar i paraqet për miratim kryeadministratorit planin e veprimit për zbatimin e mënyrës së menaxhimit, të vendosur pas studimit të fizibilitetit. Në këtë plan përfshihen edhe të ardhurat dhe shpenzimet e parashikuara.

3. Kryeadministratori, me kërkesë të administratorit të pasurisë, mund të autorizojë, sipas nevojës, ndihmën e specialistëve të fushave të ndryshme apo të personave të tjerë, të cilët shpërblehen për punën e bërë, brenda kufijve të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave dalë për këtë qëllim.

4. Në rastet e menaxhimit të drejtpërdrejtë zbatohen të gjitha procedurat ligjore në fuqi për funksionimin e një veprimtarie ekonomike në Republikën e Shqipërisë.

5. Në rastet e dhënies me qira të pasurive të sekuestruara, kryeadministratori ngre komisionin për vlerësimin e çmimit të tregut. Nëse është e pamundur dhënia me qira me çmimin

e tregut, me propozimin e administratorit të pasurisë së sekuestruar, çmimi i qirasë mund të negociohet nga kryeadministratori.

Neni 20

Administrimi i pasurisë së luajtshme

1. Pasuritë e luajtshme transportohen dhe ruhen në mjediset e caktuara nga Agjencia, përveç rasteve kur këto pasuri janë pjesë e veprimtarisë së një biznesi apo kur ato shërbejnë për dhënie të pasurisë me qira.

2. Pasuritë e luajtshme, në formë të mjeteve monetare, investohen në bono thesari ose depozitohen në llogari bankare të caktuara, për të cilat vendos kryeadministratori.

3. Kriteret e përzgjedhjes së bankave, ku do të depozitohen mjetet monetare, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.

Neni 21

Kalimi i të drejtave reale për pasuritë e sekuestruara

1. Për pasuritë të cilat dëmtohen, u bie vlera në mënyrë të ndjeshme ose me kalimin e kohës dalin jashtë përdorimit, me kërkesë të Agjencisë, gjykata vendos kalimin e të drejtave reale tek të tretët, nisur nga parimet e miradministrimit të pasurisë. Të drejtat reale nuk kalohen te personat e parashikuar në nenin 3, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar.

2. Vendimin për kalimin e të drejtave reale për pasuritë e sekuestruara gjykata e merr pasi shqyrton studimin e fizibilitetit të administratorit të pasurisë së sekuestruar.

3. Shitja e pasurisë së sekuestruar kryhet me ankand nga Agjencia, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për ankandin publik. Të ardhurat nga shitja e këtyre pasurive depozitohen në llogarinë e Agjencisë.

4. Rregullat dhe procedura e shitjes dhe depozitimi i të ardhurave nga shitja përcaktohen me udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

5. Kur vendoset revokimi i sekuestrimit, Agjencia bën kthimin e kundërvlerës së saj pronarit, sipas vendimit gjyqësor dhe parashikimeve të këtij ligji.

Neni 22

Dorëzimi i pasurive në rastet e revokimit të masës së sekuestrimit

1. Me marrjen e vendimit gjyqësor për revokimin e sekuestrimit, Agjencia, brenda 15 ditëve, njofton personin që i është sekuestruar pasuria për datën e kthimit dhe për detyrimet që janë parapaguar nga shteti, të shoqëruara me dokumentacionin financiar përkatës.

2. Agjencia njofton të gjitha institucionet dhe subjektet përkatëse për revokimin e masës së sekuestrimit të pasurisë.

3. Dorëzimi i pasurive të personit që i është sekuestruar pasuria bëhet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe shoqërohet me dokumentacionin përkatës, që i dorëzohet personit nga administratori i pasurive.

4. Pasuria dorëzohet me procesverbalin e dorëzimit të pasurisë, si dhe hartohet raport përfundimtar për mbylljen e dosjes dhe të kartelës përkatëse.

5. Pasuria nuk dorëzohet nga Agjencia, në rastin e përcaktuar në pikën 6, të nenit 31, të këtij ligji.

6. Kur brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit për revokimin e sekuestrimit, pronari i pasurisë nuk paraqitet, pa shkaqe të arsyeshme, për t'i marrë në dorëzim ato, Agjencia dhe administratori i pasurisë çlirohen nga çdo përgjegjësi.

Neni 23

Kalimi i pronës në favor të shtetit

1. Me marrjen dijëni të vendimit të gjykatës për konfiskimin e pasurive, Agjencia, brenda 30 ditëve, u kërkon institucioneve përkatëse për kalimin e pasurisë në favor të shtetit dhe në administrim të Agjencisë.

2. Me kalimin e pasurisë në favor të shtetit, Agjencia përgatit raportin tekniko-financiar me rekomandimet përkatëse për destinimin, mënyrën dhe kushtet e administrimit të pasurisë së konfiskuar dhe ia paraqet Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimin të Organizuar dhe, për dijëni, ministrit përgjegjës për financat, brenda 90 ditëve, nga njoftimi i vendimit gjyqësor për konfiskimin e pasurisë.

Neni 24

Komiteti Këshillimor Ndërinstitucional i Ekspertëve për Masat Kundër Krimin të Organizuar

1. Për mbikëqyrjen e administrimit të pasurive të konfiskuara nga Agjencia, sipas fushës së veprimtarisë përcaktuar në nenin 3, të këtij ligji, funksionon Komiteti Këshillimor Ndërinstitucional i Ekspertëve për Masat Kundër Krimin të Organizuar, i ngritur sipas përcaktimeve të nenit 35, të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", të ndryshuar.

2. Komiteti Këshillimor Ndërinstitucional i Ekspertëve për Masat Kundër Krimin të Organizuar rekomandon ministrin përgjegjës për financat për destinimin e pasurive, si dhe për përdorimin efektiv të të ardhurave brenda buxhetit të shtetit, përfshirë edhe rekomandimin për pagimin e shpenzimeve operative të Agjencisë.

Neni 25

Destinimi dhe mënyra e përdorimit të pasurive të konfiskuara

1. Ministri përgjegjës për financat, me urdhër, përcakton mënyrën dhe kushtet e përdorimit dhe destinimin e pasurive të konfiskuara dhe nxjerr udhëzimet shoqëruese të përdorimit brenda 30 ditëve nga paraqitja e raportit të vlerësimit tekniko-financiar nga Agjencia dhe rekomandimit nga Komiteti, por jo më vonë se 120 ditë nga data e njoftimit të vendimit gjyqësor.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat, përcakton kriteret, masën dhe mënyrën e përdorimit të pasurive të konfiskuara, duke u bazuar në parimet e miradministrimit të pronës.

3. Për nxjerrjen e urdhrin të destinimit të pasurive të konfiskuara, ministri bazohet në:

a) rekomandimet e Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimin të Organizuar;

b) raportin e vlerësimit tekniko-financiar të Agjencisë;

c) kriteret e përcaktuara sipas pikës 2, të këtij neni, dhe të nenit 24, të këtij ligji;

ç) respektimin për dhënien në përdorim të pasurive që shërbejnë për veprimtaritë ekonomike, tregtare dhe profesionale, pjesë e fondit të posaçëm, brenda kufijve të destinimit.

Neni 26

Përdorimi i mjeteve monetare të sendeve të konfiskuara

Administratori i pasurisë së konfiskuar kryen veprimet e nevojshme për të dorëzuar në llogaritë e Agjencisë fondet në mjete monetare:

a) të konfiskuara, që nuk do të përdoren për administrimin e pasurive të tjera të konfiskuara, ose që nuk do të përdoren për dëmshpërblimin financiar të viktimave të veprave penale të krimit të organizuar dhe trafikimit të qenieve njerëzore;

b) të përfituara nga shitja e pasurive të luajtshme, që nuk përdoren në veprimtarinë e personit juridik tregtar dhe të titujve, në vlerën neto, të përfituara nga shitja e pasurive për dëmshpërblimin e viktimave të krimit të organizuar dhe trafikimit. Nëse procedurat e shitjes nuk janë ekonomike, ministri përgjegjës për financat vendos transferimin e pronësisë pa pagesë ose shkatërrimin e pasurisë së konfiskuar nga administratori;

c) që përfitohen nga rimarrja e kredive personale. Nëse procedura e rimarrjes së tyre nuk është ekonomike ose kur, pas verifikimeve të bëra nga Agjencia për aftësinë paguese të debitorit, rezulton se ai nuk ka aftësi paguese, kreditë personale anulohen, sipas procedurës së parashikuar në nenet 22 e 23 të këtij ligji.

Neni 27

Tjetërsimi dhe dhënia në përdorim

1. Agjencia përgatit dosjen e plotë të dokumentacionit ligjor për tjetërsimin të pasurive të konfiskuara.

2. Këshilli i Ministrave, me vendim, përcakton kriteret e vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara.

Neni 28

Raportimi periodik në Këshillin e Ministrave

Agjencia, në përfundim të çdo viti financiar, i paraqet Këshillit të Ministrave dhe komisionit përgjegjës për çështjet ligjore të Kuvendit, nëpërmjet ministrit përgjegjës për financat, raportin për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, sipas këtij ligji.

Neni 29

Të ardhurat nga administrimi i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara

1. Të ardhurat nga administrimi i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara përfitohen nga:

a) dhënia me qira e pasurive;

b) administrimi i drejtpërdrejtë apo nëpërmjet të tretëve i veprimtarive ekonomike;

c) interesat e përfituara nga depozitimi i vlerave monetare në llogari bankare apo bono thesari;

ç) të ardhurat nga tjetërsimi i pasurive të konfiskuara;

d) të ardhurat nga shitja e pasurive;

dh) të ardhura të tjera në çdo lloj cilësie a burimi të ligjshëm.

2. Ministri përgjegjës për financat, me udhëzim, përcakton rregullat për mbledhjen, administrimin, mënyrën e mbajtjes dhe evidentimit të të ardhurave.

Neni 30

Shpenzimet për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara

1. Në shpenzimet procedurale përfshihen shpenzimet e sekuestrimit, të administrimit, si dhe çdo shpenzim tjetër i dokumentuar sipas ligjit.

2. Shpenzimet për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara përbëhen nga:

- a) shpenzimet për pagesën e administratorit të pasurisë dhe të personelit ndihmës;
 - b) shpenzimet për marrjen në administrim të pasurive;
 - c) shpenzimet e shërbimeve të transportit të pasurive të luajtshme të sekuestruara e të konfiskuara;
 - ç) shpenzimet për shërbimet e ruajtjes dhe të sigurisë fizike;
 - d) shpenzimet për shërbimet e siguracioneve të domosdoshme;
 - dh) shpenzimet për shërbimet e mirëmbajtjes;
 - e) shpenzimet që lidhen me shërbimet, si: riparime, rikonstrukcione, rregullime dhe shpenzime të tjera të nevojshme për mundësimin e veprimtarisë në ato pasuri, të cilat mund të gjenerojnë të ardhura;
 - ë) shpenzimet për pagesën e shërbimeve të ekspertizës dhe këshillimit teknik, për pasuritë e sekuestruara e të konfiskuara;
 - f) shpenzimet për administrimin e llogarive bankare;
 - g) shpenzimet për kalimin e pronësisë së regjistruar të pasurive të konfiskuara;
 - gj) tatimet, taksat kombëtare dhe lokale.
3. Shpenzimet për administrimin e pasurive kryhen nga Agjencia, me kërkesën e administratorit të pasurisë dhe miratimin e kryeadministratorit, përveç rasteve të administrimit të drejtpërdrejtë të pasurive.
4. Procedurat e kryerjes së shpenzimeve realizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.
5. Ministri përgjegjës për financat, me udhëzim, përcakton procedurat dhe limitet e kryerjes së shpenzimeve, si dhe rregullat për mënyrën e mbajtjes dhe evidentimit të tyre.

Neni 31

Përballimi i shpenzimeve të administrimit që lindin nga administrimi i pasurive të sekuestruara

1. Shpenzimet e nevojshme ose të dobishme për ruajtjen dhe administrimin e pasurisë së sekuestruar përballohen nga fondet e siguruar nga administratori, nga çdo burim i ligjshëm.
2. Nëse nëpërmjet administrimit të pasurisë së sekuestruar nuk përfitohen fonde të mjaftueshme për përballimin e shpenzimeve, ato parapaguhën nga shteti nëpërmjet Agjencisë, me të drejtën e kthimit të tyre nga personi, të cilit i është sekuestruar pasuria.
3. Agjencia nuk është përgjegjëse për pagimin e detyrimeve të personave të parashikuar në nenin 3, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, të maturuara përpara vendimit të sekuestrimit, lidhur me:
 - a) shpenzimet e mirëmbajtjes dhe të administrimit të zakonshëm të pasurisë;
 - b) pagesat e prapambetura të energjisë elektrike, të ujit, të telefonisë dhe pagesa të tjera të lidhura me pasurinë;
 - c) taksat ose detyrimet tatimore të prapambetura.
4. Gjykata, në vendimin përfundimtar, cakton detyrimin për pagimin e shpenzimeve të parapaguara nga shteti, sipas dokumentacionit financiar të përgatitur nga Agjencia.
5. Në rastet kur gjykata kompetente në vendimin për revokimin e sekuestrimit të pasurisë nuk përcakton detyrimet, sipas pikës 4, të këtij neni, që janë parapaguar nga shteti, pas vendimit të sekuestrimit deri në momentin e revokimit të tij, Agjencia kërkon nga gjykata që ka dhënë vendimin, plotësimin e vendimit, duke përcaktuar detyrimet përkatëse.
6. Mosplotësimi i vendimit për revokimin e sekuestrimit të pasurisë dhe/ose mospagimi i detyrimeve nga personi që i është rikthyer prona e sekuestruar, sjell si pasojë mosdorëzimin e pasurisë nga Agjencia, deri në momentin e plotësimit të vendimit nga gjykata dhe/ose të pagimit të plotë të të gjitha detyrimeve nga personi.

Neni 32

Përballimi i shpenzimeve të administrimit që lindin nga administrimi i pasurive të konfiskuara

1. Në rastet e vendosjes së masës së konfiskimit të pasurisë, shpenzimet e përballuara për administrimin e kësaj pasurie nga administratori ose Agjencia përfshihen në llogaritë e administrimit të tyre.

2. Nëse fondet e llogarive të administrimit, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk janë të mjaftueshme për të përballuar pagesën e këtyre shpenzimeve, ato paguhen pjesërisht ose plotësisht nga shteti, pa të drejtë kompensimi.

3. Agjencia nuk është përgjegjëse për kreditë për të cilat pronat e konfiskuara janë përdorur si kolateral pranë institucioneve financiare.

Neni 33

Regjistri elektronik

1. Për administrimin dhe inventarizimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, krijohet regjistri elektronik i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.

2. Regjistri elektronik i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara administrohet nga Agjencia, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

3. Këshilli i Ministrave miraton rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara dhe përcakton organet publike apo subjektet që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij.

Neni 34

Dispozitë kalimtare

Fondi buxhetor i planifikuar, pasuritë në administrim, personeli, të drejtat dhe detyrimet kontraktore me të tretët, arkivi, mjetet e punës, logjistika, baza materiale të Agjencisë së krijuar sipas vendimit nr. 687, datë 5.10.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, rregullat e hollësishme për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe mënyrën e administrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, të ndryshuar, i transferohen Agjencisë së krijuar sipas këtij ligji.

Neni 35

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 25, pika 2, 27, pika 2, e 33, pika 3, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për financat që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 20, pika 3, 21, pika 4, 29, pika 2, e 30, pika 5, të këtij ligji.

Neni 36

Shfuqizime

1. Pika 2, e nenit 34, të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, shfuqizohet.

2. Vendimi nr. 687, datë 5.10.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, rregullat e hollësishme për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe mënyrën e administrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar, si dhe çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, shfuqizohen.

Neni 37

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 30 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.6.2019

Shpallur me dekretin nr. 11216, datë 4.7.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.